



UDHËZIM NR.3

Tranzicioni i OHSAS 18001

te ISO 45001

2020



**Rr. Sulejman Pasha, Pallati 70/1, Kati 1,
Nr.1 1016 Tiranë**

Ky dokument parashtron udhëzimet e EQSC për klientët e saj, për periudhën e tranzicionit të ndryshimit nga BS OHSAS 18001 në ISO 45001, të Sistemeve të Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në punë.



Siguria dhe Shëndeti në Punë

Përmbajtja

E përgjithshme	2
1. ISO 45001.....	4
1.1 Çfarë është ISO 45001?.....	4
1.2 Çfarë nuk është ISO 45001?.....	4
2. Periudha e tranzicionit.....	4
2.1 Klientët ekzistues.....	5
2.2 Klientët e rinj.....	7
3. Rishikimi i Sistemit të Menaxhimit nga Klientët.....	7
4. Përfundimi i periudhës së tranzicionit	7
5. Ndryshimet thelbësore të ISO 45001 krahasuar me OHSAS 18001	8



Siguria dhe Shëndeti në Punë

E përgjithshme

Situata në fushën e mbrojtjes së punës dhe OH & S (shëndeti dhe siguria në punë) është ndikuar nga shumë faktorë, p.sh. nga përhapja e teknologjive të reja. Teknologjitë e reja do të krijojnë mënyra të reja të punës dhe do të ndryshojnë llojin e punës së ofruar. Profili i moshës së personit të punësuar po ndryshon gjithashtu. Për shkak të globalizimit, rreziqet që lidhen me shëndetin që dikur nuk konsideroheshin mund të përhapen në mbarë botën brenda një kohe të shkurtër. Nëse duam të mbrojmë shëndetin e punonjësve tanë dhe të mirëmbajmë forcën ekonomike dhe konkurrencën, do të duhet të përballojmë këto sfida në mënyrë proaktive. Sistemet e menaxhimit të sigurisë mbështesin veprimin parandalues dhe na ndihmojnë për të menaxhuar sfidat që lidhen me sigurinë.

BS OHSAS 18001 është një kornizë sistemi menaxhimi mbi shëndetin dhe sigurinë në punë (SHSP) dhe është pjesë e serisë së standardeve OHSAS 18000 (nganjëherë e identifikuar gabimisht si ISO 18000), së bashku me OHSAS 18002. Ky grup standardesh deri më tani i ka ndihmuar kompanitë për të përcaktuar politikat, procedurat dhe kontrollat e nevojshme për të arritur kushtet më të mira të mundshme të punës dhe shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës, në përputhje me praktikën më të mira të njohura ndërkombëtare.

Në 12 Mars 2018, ISO publikoi standardin e tij ISO 45001:2018. Ky standard mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, do të ndihmojë organizatat që ta zvogëlojnë barrën e lëndimeve dhe sëmundjeve në vendin e punës, duke ofruar një kornizë për të përmirësuar sigurinë e punonjësve, për të zvogëluar rreziqet në vendin e punës dhe për të krijuar kushte më të mira pune, anë e mbanë botës.



Siguria dhe Shëndeti në Punë

Ky dokument shërben për të informuar klientët, stafin dhe palët e interesuara, mbi procedurën e tranzicionit, e detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë klientët e EQSC, në proces certifikimi apo klientë të rinj. EQSC e ka organizuar procesin e tranzicionit në 4 etapa, siç janë shpjeguar më poshtë.

Periudha 3 vjeçare e tranzicionit





Siguria dhe Shëndeti në Punë

1. ISO 45001

Më 12 mars 2018 u publikua versioni i parë i standardit ISO 45001 për sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë (OH & S), i cili zyrtarisht, njihet si ISO 45001:2018. Standardi ISO 45001 do të zëvendësojë standardin OHSAS 18001.

1.1 Çfarë është ISO 45001?

ISO 45001 është një standard ndërkombëtar që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurisë në punë (SH&SP), me udhëzime për përdorimin e tij, për të mundur një organizatë që të përmirësojë në mënyrë proaktive performancën e shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve të saj.

ISO 45001 ka për qëllim të jetë i zbatueshëm për çdo organizatë pavarësisht nga madhësia, lloji dhe natyra e saj.

Të gjitha kërkesat e këtij standardi synojnë të integrohen në proceset e menaxhimit të një organizate.

1.2 Çfarë nuk është ISO 45001?

ISO 45001 nuk përcakton kriteret specifike për performancën e SH&SP, dhe as nuk është detyruese për hartimin e një sistemi menaxhimit të SH&SP. Sistemi i menaxhimit të SH&SP të një organizate **duhet të jetë specifik** për plotësimin e nevojave të organizatës në parandalimin e lëndimeve dhe problemeve të shëndetit; rrjedhimisht një biznes i vogël me rreziqe të ulëta mund të ketë nevojë vetëm për të zbatuar një sistem relativisht të thjeshtë, ndërsa një organizatë e madhe me nivele të larta rreziqesh, mund të ketë nevojë për diçka shumë më të sofistikuar. Çdo lloj sistemi mund të jetë në gjendje të jetë në përputhje me kërkesat e standardit, me kusht që të mund të tregohet i përshtatshëm për organizatën dhe është efektiv.

ISO 45001 nuk trajton në mënyrë specifike çështje të tilla si siguria e produkteve, dëmtimi i pronës ose ndikimet mjedisore dhe një organizatë nuk është e nevojshme të marrë parasysh këto çështje, përveç nëse paraqesin rrezik për punonjësit e saj.

ISO 45001 nuk synon të jetë një dokument ligjërish i detyrueshëm, por është një mjet menaxhimi për përdorim vullnetar nga organizatat, qëllimi i të cilave është të eliminojë ose minimizojë rrezikun e dëmit.

2. Periudha e tranzicionit

Nga 12.03.2018, një periudhë tranzicioni prej tre vjetësh planifikohet për organizatat e certifikuara OHSAS 18001.

Kjo periudhë tranzicioni tre vjeçare është vendosur nga organizata ISO për këtë arsye respektohet edhe nga EQSC, në përputhje me përcaktimet e mëposhtme.

Për shkak të situatës së jashtëzakonshme të COVID-19, IAF ka publikuar shtyrjen e vlefshmërisë së tranzicionit nga OHSAS në ISO 45001 deri më 30.09.2021.



Siguria dhe Shëndeti në Punë

2.1 Klientët ekzistues

EQSC ka përcaktuar që për klientët ekzistues, periudha nga publikimi i standardit **12.03.2018** deri në datën **30.06.2020** është e nevojshme që klientët të vlerësojnë mundësinë për tranzicionin e sistemit të tyre. Për shkak të situatës së jashtëzakonshme të COVID-19, dhe bazuar në publikimet e IAF për shtyrjen e vlefshmërisë së tranzicionit nga OHSAS në ISO 45001, të gjitha certifikatat e lëshuara OHSAS e kanë vlefshmërinë deri më 30.12.2020.

Gjatë kësaj periudhe,

- a) klientët kanë të drejtë përpara **auditimeve mbikëqyrëse dhe të ricertifikimit**, të kërkojnë auditimin sipas ISO 45001:2018. Kur auditimet e kalimit nga OHSAS në ISO 45001, kryhen gjatë auditimeve mbikëqyrëse ose të ricertifikimit, siç janë planifikuar më parë në ciklin e certifikimit, atëherë EQSC ju njofton se bazuar në IAF MD 21 dhe IAF MD22, kohës normale të auditimit do të shtohet një minimum prej 1 ditë auditimi/njeri. Në këtë mënyrë EQSC do të mundësojë auditimin e plotë të kërkesave ekzistuese dhe të reja, të OHSAS dhe ISO 45001: 2018.
- b) në rast se klienti kërkon një auditim të veçantë, pasi e ka kaluar auditimin e planifikuar mbikëqyrës apo të ricertifikimit, ju njoftojmë se ky auditim **mund të kryhet** por do të ketë orë auditimi shtesë, krahasuar me pikën a) më sipër, në përputhje me IAF MD 21 dhe IAF MD22.
- c) nëse klienti e kërkon, certifikatat OHSAS 18001 dhe ISO 45001, do të jenë paralelisht të vlefshme.
- d) Certifikatat e akredituara të ISO 45001: 2018 do të lëshohen vetëm pasi EQSC të jetë akredituar për të ofruar certifikim në standardin e ri dhe pasi Sistemi i Menaxhimit të klientit të ketë demonstruar konformitetet me ISO 45001: 2018.
- e) Nëse klienti kërkon të auditohet përpara se të akreditohet EQSC, dhe bie dakort me procedurat e EQSC, atëherë EQSC mund të lëshojë certifikatë të **pa-akredituar** në përputhje me ISO 45001:2018. Kjo certifikatë e paakredituar, do të rishikohet nga EQSC, pas akreditimit të tij.



Siguria dhe Shëndeti në Punë

Rekomandimet e EQSC për procesin e tranzicionit

Kuptoni sa më mirë standardet e reja dhe ndryshimet krahasuar me versionet e mëparshme.

Standardet kanë terma e koncepte të reja, ndaj është e rëndësishme studimi i tyre, marrja pjesë në trajnimet e organizuara nga EQSC apo kompani të tjera, si dhe të studiohen me vëmendje Anekset e standardeve të cilat japin shpjegime të rëndësishme.

Identifikoni pikat më të rëndësishme dhe përdorini ato në zhvillimin e sistemit tuaj

Në këtë kontekst disa nga ndryshimet më të rëndësishme dhe me vlerë për kompaninë, janë rreziku dhe mundësitë si dhe konteksti i organizatës: p.sh. plani i biznesit, planifikimi dhe kryerja e vlerësimit të kompetencës dhe/ose njohurive të organizatës. Këto janë pika të cilat duhet të adresohen sa më shpejt në mënyrë që të lehtësohet procesi i tranzicionit.

Përcaktuar momentin kur do të ndryshoni sistemin sipas standardeve të ndryshuara

Duhet të zgjidhni momentin më të përshtatshëm për ju, për të kryer ndryshimin. Ky moment duhet të vlerësohet duke pasur në konsideratë këtë udhëzim, por edhe kontakte për sqarime me EQSC.

Realizoni ndryshimet!

Zbatimi i kërkesave të rishikuara të standardeve kërkon një kohë të mjaftueshme për të dhënë rezultatet e saj. Për këtë arsye është e nevojshme që përpara se të aplikoni për certifikim sipas standardeve të reja, të kryeni një Auditim të brendshëm nëpërmjet të cilit do të keni një pasqyrë më të qartë të realizimit të ndryshimeve dhe nevojës për përshtatje të reja.

Aplikoni për Certifikim

Pasi të siguroheni se procesi i zbatimit të ndryshimeve është i finalizuar, EQSC ju mirëpret për aplikimin për certifikim sipas standardeve të ndryshuara. EQSC ka filluar procesin e akreditimit për këto standarde dhe në momentin e aplikimit të parë, do të mundësojë dhënie e certifikatave sipas standardeve të reja, të akredituara.

Këto janë thjesht Rekomandime!

Kini parasysh se vetë kompania juaj është përgjegjëse për procesin e tranzicionit dhe përputhjen e Sistemit tuaj me kërkesat e standardit.



Siguria dhe Shëndeti në Punë

2.2 Klientët e rinj

Klientët e rinj, të cilët hyjnë në Sistemin e certifikimit të EQSC gjatë periudhës nga publikimi i standardit **12.03.2018** deri në datën **30.06.2020**, kanë mundësi të përzgjedhin nëse duan të certifikohen sipas OHSAS 18001 ose ISO 45001, ose të dyja.

Në rast se përzgjedhin direkt të zbatojnë vetëm Sistemin e Menaxhimit të SHSP sipas ISO 45001, klientët e rinj do të ndjekin procedurën e certifikimit të EQSC dhe nuk do të kenë kufizime në periudhën e tranzicionit, pasi do të ndiqet cikli i certifikimit në përputhje me ISO 45001 dhe standardet përkatëse.

Në rastin e përzgjedhjes së OHSAS + ISO 45001, ose vetëm të OHSAS, kërkesat e përcaktuara në këtë dokument për periudhën e tranzicionit, janë të vlefshme.

3. Rishikimi i Sistemit të Menaxhimit nga Klientët

Të gjithë klientët aktualë dhe të rinj, të cilët aplikojnë për certifikim pranë EQSC sipas ISO 45001:2018, kanë afat deri në **2 muaj nga mbarimi i vlerëshmërisë së OHSAS** të njoftojnë EQSC rreth statusit të zbatimit të kërkesave të standardit, në Sistemin e tyre të Menaxhimit.

EQSC i nxit klientët, që të konsiderojnë përpara datës së auditimit të çdo viti, njoftimin e EQSC se Sistemi i tyre i Menaxhimit është i gatshëm për tu audituar në përputhje me ISO 45001. EQSC do të vlerësojë këto njoftime, dhe planifikojë auditimet sipas procedurave përkatëse të saj, për të gjithë klientët.

Afati më i fundit i zhvillimit të auditimit sipas ISO 45001, për klientët e certifikuar OHSAS 18001 dhe që duan të ruajnë ciklin e certifikimit, do të jetë data **30.07.2021**.

Kjo periudhë, do të shërbejë për të dhënë mundësinë kohore të duhur për mbylljen e jokonformiteteve të evidentuara gjatë auditimit si dhe përfundimin e procesit të vendimmarrjes së certifikimit. Në këtë mënyrë klientët dhe EQSC do të kenë mundësi të respektojnë afatin e mbarimit të certifikatave të lëshuara sipas standardit të shfuqizuar, dhe do të mundësoj që të gjithë klientët të jenë e pajisur me certifikatat sipas standardit të ri.

EQSC nuk do të pranojë auditime sipas OHSAS 18001 pas datës 1.07.2021.

Në rast se klienti nuk do të aplikojë për certifikim ISO 45001, pas datës 30.12.2020, Klienti do të mbajë vetë përgjegjësinë e mbarimit të afatit të certifikatës sipas OHSAS 18001.

4. Përfundimi i periudhës së tranzicionit

Pas datës **20.12.2020** vlefshmëria e të gjitha certifikatave të lëshuara të akredituara, sipas OHSAS **do të pushojë së ekzistuari**.

Pas kësaj date, nuk mund të pranohen nga EQSC aplikime për certifikim sipas këtij standardi.



Siguria dhe Shëndeti në Punë

5. Ndryshimet thelbësore të ISO 45001 krahasuar me OHSAS 18001

Krahasuar me OHSAS 18001, ISO 45001 ka ndryshime të rëndësishme, por një krahasim i detajuar është i pamundur, pasi teksti i ISO 45001 është tërësisht i ri.

Më poshtë përmbledhim disa prej këtyre ndryshimeve:

- ⊙ Struktura e standardit është e përshtatur me Strukturën e Nivelit të Lartë (High Level Structure), duke lehtësuar kështu integrimin e disa standardeve në një Sistem të vetëm Menaxhimi.
- ⊙ Standardi fokusohet në **orientimin drejt procesit**, dhe shpjegon përse është thelbësor të zbatohet në të gjithë aktivitetet e organizatës;
- ⊙ Janë përcaktuar kërkesa specifike për menaxhimin e lartë në drejtim të demonstrimit të **leadershipit**, përkushtimit dhe inkurajimit të një kulture pozitive të shëndetit dhe sigurisë në punë, në të gjithë organizatën. Duke vendosur theks më të madh te leadershipi, është hequr kërkesa për **“caktimin e një përfaqësuesi të menaxhimit – Menaxheri i S&SHP”**.
- ⊙ Janë reduktuar kërkesat administrative, pra më pak dokumente (p.sh nuk kërkohet më me detyrim që të ketë një manual të S&SHP, etj.). Në këtë standard është konsideruar evoluimi në teknologji (përdorimi i kompjuterëve, bazave të të dhënave, sistemeve “cloud”, etj.), duke zëvendësuar termat dokument“ dhe “regjistrim/rekord” me termin e ri **“informacion i dokumentuar”**.
- ⊙ Është përfshirë kërkesë mbi përcaktimin e **kufijve të sistemit** të menaxhimit dhe **zbatueshmërisë** së tij.
- ⊙ Është përfshirë kërkesë mbi të kuptuarit e **Kontekstit të organizatës** dhe pritshmërive të palëve të interesuara.
- ⊙ ISO 45001 fokusohet në **identifikimin dhe kontrollin e rreziqeve**, në vend të rreziqeve potenciale (hazard) siç kërkohet në OHSAS 18001.
- ⊙ OHSAS nuk përcakton ndryshimin midis aktiviteteve të “pjesëmarrjes” dhe “konsultimit”, ndërkohë që në ISO 45001 bëhet një dallim midis **këtyre dy aktiviteteve**, ndërmjet fazave të ndryshme të zbatimit / funksionimit të OH & SMS, dhe pjesëmarrja / konsultimi lidhet me të gjitha segmentet e sistemit të menaxhimit.
- ⊙ Është përfshirë kërkesë mbi **identifikimin e “mundësive”**, duke bërë një diferencë midis rreziqeve dhe mundësive të S&SHP dhe rreziqeve dhe mundësive të organizatës.
- ⊙ Është përfshirë kërkesë e re për **“Planifikimin e veprimeve”**.
- ⊙ Si edhe në OHSAS, janë përfshirë objektivat e S&SHP. Kërkesë e re është **“përcaktimi i treguesve”** mbi të cilët do të vlerësohet ecuria si dhe organizata duhet të konsiderojë se si veprimet që duhet të ndërmarrë për të arritur këto objektiva, duhet të integrohen me proceset e tjera të biznesit.
- ⊙ Janë përfshirë përcaktimet për **kompetencën e punonjësve** (aftësitë, njohuritë, trajnimet, eksperiencën). Gjithashtu është përfshirë koncepti “kulturë”.
- ⊙ Nëse në OHSAS kërkohet që organizata të kishte një procedurë për **komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm**, ISO 45001 kërkon një proces që tregon se me kë, kur dhe si është kryer komunikimi.
- ⊙ **Menaxhimi i ndryshimit**, është bërë kapitull më vete.



Siguria dhe Shëndeti në Punë

- ⊙ Gjatë **Rishikimit të menaxhimit**, është vënë theksi në pjesëmarrjen aktive të Menaxhimit të lartë gjatë mbledhjes së rishikimit të menaxhimit. Janë përcaktuar më qartë çështjet që do të trajtohen gjatë kësaj mbledhje si dhe janë shtuar elementë të rinj.

Kjo është një përmbledhje e shkurtër e ndryshimeve thelbësore të standardeve. Për tu njohur më tepër me ndryshimet e standardeve, jeni të mirëpritur të merrni pjesë në **trajnimet profesionale të ofruara nga EQSC**.